

**Korçë, më 18 Mars 2024**

**Lënda:**

**KËRKESE PËR MIRËNJOHJE PËR BENON PROGRIN  
DHE VËMENDJE INSTITUCIONALE PËR BENONIZMIN**

**Drejtuar:**

- Kryetares së Këshillit Bashkiak Korçë, Znj. Ana VERUSHI;
- Sekretares së Këshillit Bashkiak Korçë, Znj. Eva NAÇI.

**Në dijeni:**

- Anëtarët e Këshillit Bashkiak Korçë;
- Kryetari i Bashkisë Korçë, Z. Sotiraq FILO;
- Komisionet relevante pranë Këshillit Bashkiak Korçë;
- Institucionet dhe Departamentet relevante në varësi të Ekzekutivit të Bashkisë Korçë;
- Shoqëria Civile;
- Komuniteti i artistëve;
- Komuniteti i ambientalistëve;
- Institucionet Arsimore;
- Media;
- Publiku i gjerë.

Të nderuara zonja, tungjatjeta!

Doja t'ju propozoja një tematikë për t'u konsideruar nga Kryesia e institucionit të Këshillit Bashkiak Korçë, në mënyrë që Këshilli Bashkiak të kishte mundësinë të kalonte në sitën e vet të vendimmarrjes:

- 1) të shprehurit e mirënjohjes institucionale, për bashkëqytetarin tonë, Z. Benon Progrin, për shpalljen e tij "Qytetar Nderi të Korçës"
- 2) nisjen e procedurave për çeljen e një thirrjeje publike të 1 konkursi profesional, për vendosjen e një *instalacioni artistik bashkëkohor* në mjediset e Parkut Rinia të qytetit të Korçës, si simbol të respektit për Natyrën dhe si personifikim i të gjithë njerëzve që janë të përlulur dhe punëtorë shembullorë-frymëzuar nga Benoni, që për shumëkënd konsiderohet si njeriu që e shpëtoi këtë park nga shfarosja!

## **Pse ky propozim dhe pse kjo kërkesë kaq specifike?**

Një nga mënyrat efektive që njeriu vlerëson dobinë e gjërave që ka, është të përfytyruarit, qoftë edhe për 1 çast, sikur të mos i kishte. Fjala vjen, në do të jesh falenderuese që e ke dritën e syve dhe që sheh më së miri, provo të përjetosh mungesën e tyre... A nuk vlen kjo metodë edhe për komunitetet që përfaqëson Këshilli Bashkiak i Korçës, nga gjiri i të cilëve spikasin virtyte thellësisht të veçanta të njerëzve si puna e Benonit?

Mjafton të pyesim: si do të ishte sot Korça, pa Parkun Rinia, që e mbrojt nga shfarosja Benoni?! A ka edhe *benonë* të tjerë Korça?! A është personifikimi i Benonit, mjaftueshmërisht i denjë për të qënë një vlerë përbashkuese e virtyteve të mira, ku shkëlqen virtyti për ta mbrojtur me guxim dhe devotshmëri, pasurinë tonë të përbashkët shpirtërore dhe materiale (lexo: benonizmi)?

Parku Rinia, është një nga rastet emblematike ku pasuria jonë e përbashkët shpirtërore e parkut shkrihet me pasurinë materiale të parkut dhe ku drurët janë ndoshta elementët kryesorë. Unë mendoj se Korça pa Parkun Rinia do të ishte e cinguar dhe Parku Rinia pa drutë -e mbrojtura nga Benoni për të mos rrezikuar prerjen-, pa ato pemë, pra, ky Park do të ishte i paplotë. Mendoj gjithashtu se Benoni na vjen së bashku me *benonizmin*, dukuri kjo, që e gjen mjaft rrallë tek njerëzit. *Benonizmi* është të vepruarit *drejt* pavarësisht rrethanave dhe shoqëria jonë aktuale ka nevojë gëlthitëse për një moral të tillë qytetar!

Ndaj edhe po vij me këtë propozim konkret: sepse mendoj se tek Benoni mishërohet si kujtesa, si mirënjohja, si vetëdija shoqërore për mbrojtjen e parkut më të madh dhe më të dashur urban të qytetit të Korçës: Parkut Rinia; ashtu edhe *benonizmi* si dukuri frymëzuese.

## **Ku qëndron vlera e patjetërsueshme e Benonit në historinë moderne të Korçës dhe pse të shpallurit e Benonit "Qytetar Nderi i Korçës" do të ishte në nderin e Këshillit Bashkiak?**

Historia moderne e Korçës, lidhet pazgjidhshmërisht me historinë moderne të Shqipërisë. Kështu, dukuria e kërcënimit të vlerave natyrore dhe kulturore që është shpërfaqur në rang vendi, është hasur edhe në antropologjinë e Korçës dhe korçarëve.

*"Urrejtja ndaj shtetit dhe indiferenca ndaj bashkësisë kanë natyrisht shkaqe historike, dmth ato nuk duhen parë si një fatalitet i pashmangshëm shqiptar"* - thotë Ardian Klosi tek libri *"Shqipëria ç'mund të jetë"*, ku trajton edhe fenomenin e *urrijtjes së thellë dhe armiqësisë së hapur* ndaj pronës shtetërore. Klosi shton se shkatërrimet e viteve 90' të cilat përfshinë gjithçka që nuk ishte individuale, nuk duhen lexuar si instikt vetëshkatërrimi, por si urrejtje e pavetëdijshme e qytetarëve, që kishte gjetur rastin të shpërthente e papenguar, e verbër, e gjithanshme.

Dhe pikërisht këto trauma vullkanike të psikologjisë sonë kolektive, në kapërcyell të ndryshimeve sociale, ekonomike dhe politike të viteve 1991-1992 dhe sidomos viti i mbrapshtë 1997, do ta gjenin Benonin me detyrën e rojtarit të pyllit. Benoni nuk u struk në ndonjë rehati të interesit tërësisht personal dhe familjar, por përkundrazi, ndonëse mes plumbash dhe kërcënimit për jetën- pavarësisht rrethanave të kobshme të asaj vrime të zezë të historisë sonë-, zgjodhi të merrte përgjegjësi shoqërore dhe bëri çmos për ta mbrojtur Parku Rininë nga skizofrenia shoqërore! Dhe ia doli!

Në mungesë të asaj mbrojtjeje që do t'ia garantonte Parkut Benoni, me gjasë Parku Rinia do të ishte shfarosur, e bashkë me të, krejt pylli i atij parku me vlera rekreative, për të madh e të vogël dhe për të cilin ishin dashur gjysmë shekulli përkujdesje.

Ndaj, nuk do ta tepronim aspak të thoshim që, nëse ka sot Korça 1 park të bukur dhe urban, si Parku Rinia, kjo është para së gjithash prej atij njeriu, që në mendjet dhe zemrat e mjaft korçarëve njihet dhe personifikohet me 1 emër, kapistalli i të cilit të drejton tek: Benoni.

### **A jemi tepër vonë për këtë vlerësim të propozuar dhe çfarë do ishte e udhës të bëhej?**

Edhe pse ka rrjedhur shumë ujë nga viti aq i mbrapshtë për shqiptarët, 1997, Këshilli i sotëm Bashkiak i Korçës, me mundësinë për ta vlerësuar dhe shpallur Benonin "Qytetar Nderi të Korçës", do të vinte në vend nderin dhe respektin institucional të munguar kundrejt këtij njeriu, të mirën e të cilit i'a di, i'a do dhe i'a respekton një komunitet i tërë korçarësh!

Druaj se me vlerësimin institucional për Benonin dhe materializimin artistik dhe konceptual, të asaj që personifikon Benoni, jemi tashmë shumë të vonuar. Prapëseprapë, kjo vonesë nuk ka pse të mahiset edhe më dhe të mbërrijë në kufijtë e asnjëherës, sepse kemi rastin që tani, me parimin "*më mirë vonë sesa kurrë*" ta shlyejmë gabimin e kësaj vonese, përmes dhënies së këtij Titulli të merituar për Benonin, duke krijuar kësajsoj edhe mundësinë që të reflektojmë sa duhet e si duhet- nëpërmjet fuqisë së artit: për aktet kurajoze të njerëzve si *Benoni*, për ta bërë *benonizmin* të flasë dhe të jetë përherë i gjallë përmes komunikimit artistik të instalacionit, si edhe për shkallën e respektit dhe dashurisë që meriton Natyra.

Ndaj, do të ishte e udhës që në njërën anë, të mund të vlerësonim individin dhe qytetarin Benon Progrid, me dhënien e një titulli honorifik, si ai i "*Qytetarit të Nderit*", dhe në anën tjetër të vinim theksin e vëmendjes tek *benonizmi*, dukuri e cila do të gëzonte vlera didaktike për brezat sot dhe nesër, nëse do të paraqitej në trajtë të dukshme, të prekshme dhe simbolike, nëpërmjet vendosjes së 1 instalacioni artistik, i cili më shumë sesa kudo tjetër, do t'i rrinte për shtat të vendosej pikërisht në zemër të parkut që e shpëtoi Benoni.

Ky instalacion do ta meritonte të lindte si frut i një pune gjithëpërfshirëse dhe demokratike, përgjatë të gjitha fazave: që me shpalljen e konkursit dhe përzgjedhjen e jurisë, në përzgjedhjen e artistëve; në planifikimin dhe caktimin e 1 buxheti të posaçëm për mbarëvajtjen e konkursit, punës konceptuale dhe materialeve, e deri në realizimin dhe vendosjen në një vend të dukshëm të Parkut Rinia, për t'u mirëmbajtur nga vetë qytetarët siç do i kishte hije sinjifikancës, si pasqyrë vlerash që do të rrezatone ajo vepër, për vendësit dhe të huajt.

Gjithashtu, të 3 elementët që më vete do të ishin:

- 1) vlerësimi institucional i Benonit dhe personifikimi i *Benonit*;
- 2) *komunikimi i artit përmes benonizmit*;
- dhe 3) prania e instalacionit me karakter konceptual, simbolik dhe artistik;

.... do të ishin 1 dhe të pandara nga njëra tjetra, sepse si të tilla do të gëzonin vetinë e një katharsisi të shëndetshëm shpirtëror dhe të një *ftesë për ta rilexuar dhe për ta ngritur vetëdijen shoqërore të tranzicionit të sotshëm, ku jemi sa aktorë aq edhe dëshmitarë*; ky instalacion do të brumoste vetinë që e kanë nyjet nevralgjike, tek të cilat pasqyrohet si ajo që bën njeriu nën errësirën e pavetëdijes, po ashtu edhe ajo që mund të nxjerrim në dritë së bashku, në qofshim dhe në zgjedhshim të jemi të vetëdijshëm!

Nga ju, pra, zonja të nderuara, do të doja ndihmën tuaj, për t'u çelur rrugën procedurale këtyre 2 kërkesave të lartpërmendura, duke i përcjellë për rendin e ditës, të mbledhjes së ardhshme të Këshillit Bashkiak Korçë (28 Mars 2024) dhe duke e mbështetur me sa të mundeni këtë propozim, në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe sidomos ligjit "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Me respekt,

Lazjon PETRI